



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRAK LIPLJAN

P.nr.629/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetem gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale, ndaj të akuzuarit B.A. nga fsh. G. e E. K. L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.nr.2059/2015 të dt.16.09.2016, për shkak të vepres penale Vjedhje nga neni 325 par. 2 të KPRK-së, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur me dt.07.02.2017, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurores Fatmire Cacaj, dhe të akuzuarit, me dt. **08.02.2017**, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

B. A., nga i ati A., dhe e ëma Gj., e gjinisë A., i lindur me dt.*data e lindjes...*, në fsh. G. e E. K. L., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal *numër personal...*, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt. 05.04.2015, në fshatin G., Komua L., me qëllim që vetit tis jell përfitim pasuror të kundërligjëm, i pandehuri nga ara e tani të dëmtuarit F.A., ka marrë 20 trupa pemë mollë dhe i ka mbjrrllur në arën e vetë, me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material.

-Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 par 2 të KPRK-së,

Andaj gjykata conformë nenit 1, 2, 4, 6, 7, 17, 73, 85, 86, 325 par 1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit i shqipton:

V Ë R E J T J E G J Y Q Ë S O R E

Të akuzuarit **B.A.**, i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën vepër penale, dhe nëse kryen prapë vepër të tillë, gjykata do ti shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

I dëmtuari F. A. nga fsh. G. e E. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në contest të rregullt civil.

DETYROHET i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor kësaj gjykate t'ia paguajë shumën prej 20- €, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzen e saj, PP.II.nr.2059/2015 të dt.16.09.2016, e ka akuzuar të pandehurin S. M. nga fsh. K. K. L. për shkak të veprës penale Asgjësimi, Vjedhje nga neni 325 par 2 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar përfaqësuesi i Prokurorisë ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së precizuar, dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit nga se pranimi i tillë është i mbështetur në dispozitat ligjore, dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor, pasi që e ka kuptuar në tërësi aktakuzën i njëjti e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktit akuzues, dhe njëherit ka shtuar se fidanet nuk i ka nxjerrur nga ara e të dëmtuarit, por kanë qenë në skaj të arës të cilat janë zbratur nga një kamionetë, dhe i njëjti i ka mbjellur në arën e tij, mirëpo me të kuptuar se të pemët janë të dëmtuarit, të njëjtat i ka mbjellur në arën e tij, dhe gjithashtu kësaj gjykate i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëriten vepra të tilla të ngjashme.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurit, për veprën penale Vjedhje nga neni 325 par. 2 të KPRK-së

Me rastin e përcaktimit të llojit të dënimit dhe të lartesisë se tij gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, dhe sjelljen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra, e veçanërisht pranimin e fajësisë, e në mungesë të rrethanave rënduese, conform nenit 4 të KPRK-së, ndaj këtij të akuzuari ka vazhduar me shqiptimin e vërejtjes si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se edhe me një lloj të veçantë të sanksionit verbal jondëshkues, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 85 të KPRK-së që ka për qëllim ti jepet kryesit qortimi kur, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit.

Vendimi për shpenzimet e paushallit gjyqësor u bazua në nenin 450 par. 2 pika. 2. 6 të KPPK-së.

Vendimin për kërkesen pasurore-juridike gjykata e bazoi në nenin 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN.

P.nr. 629/16 dt.08.02.2017

Sekretarja juridike,
Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtijë aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të së njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësajë gjykate.